



# BULETIN JAVOR

3-7 QERSHOR 2024



## PËRMBAJTJA

- AKSK në Bashkëpunim me SEI dhe Departamentin Amerikan të Shtetit zhvillon trajnimin për Menaxhimin e Riskut në Organizata
- Webinar online me temë: "Qeverisja dhe standardet e sigurisë kibernetike"

### AKSK në Bashkëpunim me SEI dhe Departamentin Amerikan të Shtetit zhvillon trajnimin për Menaxhimin e Riskut në Organizata



Rritja e kapaciteteve për vlerësim dhe menaxhim të riskut në sigurinë kibernetike është një nga objektivat e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK). Për këtë qëllim, më datat 3-5 Qershor, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me Software Engineering Institute (SEI) dhe me mbështetje të Departamentit Amerikan të Shtetit, organizuan trajnimin onsite dhe online me temë "Enterprise Risk Management".

Ky trajnim u zhvillua me pjesëmarrje të punonjësve të profilizuar në IT/ICT/siguri kibernetike dhe instruktorë nga Software Engineering Institute (SEI), Universiteti Carnegie Mellon.

### Webinar online me temë: "Qeverisja dhe standardet e sigurisë kibernetike"

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike do të organizojë webinarin e radhës me Temë: "Qeverisja dhe Standardet e Sigurisë Kibernetike". Pavarësisht nëse jeni profesionist me përvojë apo sapo keni nisur udhëtimin tuaj, ky webinar është për ju dhe do t'ju ofrojë njohuritë si:

- Cilat janë strategjitë për të menaxhuar qeverisjen dhe rreziqet e sigurisë kibernetike;
- Cilat janë standardet kryesore në menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe roli i tyre në ruajtjen e sigurisë;
- Hapat kryesorë për zbatimin efektiv të një kuadri Governance, Risk and Compliance (GRC) duke përfshirë vlerësimin e rrezikut, zhvillimin e politikave dhe trajnimin e punonjësve.

Ky sesion informues do të fillojë në:

- 20 Qershor, Ora 15:00-16:00, Online, nga: Gerald Bici

AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

WEBINAR ONLINE

### QEVERISJA DHE STANDARDET E SIGURISË KIBERNETIKE

E ENJTE  
20 QERSHOR 2024

ORA  
15:00 - 16:00

REGJISTROHUNI TANI



GERALD BICI  
Cybersecurity Expert



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



[www.asks.gov.al](http://www.asks.gov.al)



@autoriteti\_kombetar\_sk



+355 422 21 039